



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.156/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muhamet Rexha dhe Ferit Osmani, duke vendosur përkitazi me ankesat e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Prizren, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren, për shkak të vendosjes së banerave mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare që do të mbahen me 08.06.2014, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohen si të bazuara ankesat e Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Anr.156/2014 dhe Anr.157/2014 të datës 04.06.2014 dega në Prizren, kështu që subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Prizren i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 900 (Nëntëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

PZAP-i, me datën 04.06.2014, ka pranuar ankesat Anr.156/2014 dhe Anr.157/2014, nga LVV, me të cilat pretendohet se me datën 03.06.2014, subjekti politik LDK, ka vendosur posterët e kandidatëve të tyre për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi rrugë publike.

- Sipas ankesës Anr.156/2014, pretendohet se me datën 03 qershor 2014 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje nga Qendra në Prizren, në ora 12:00 kanë vërejtur se mbi udhëkryqin që lidh rrugët “Jeronim De Rada” dhe “Westley Clark” në qytetin e Prizrenit ishte vendosur baneri i kandidatit Xhavit Ukaj nga subjekti politik i LDK-së. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik në fjalë ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur dy fotografi.
- Sipas ankesës Anr.157/2014, pretendohet se me datën 03 qershor 2014 rreth orës 12:00 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) nga Qendra në Prizren, kanë vërejtur se mbi udhëkryqin që lidh rrugët “Jeronim De Rada” dhe “Westley Clark” në qytetin e Prizrenit ishte vendosur baneri i kandidatit Hatim Baxhakut nga subjekti politik i LDK-se. Parashtruesi i ankesës thekson se në këtë rast subjekti politik LDK ka bërë shkelje të nenit 4.1 pikës b të Rregullës Zgjedhore 13/2013 të KQZ-së. Lidhur me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur dy fotografi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, dhe 120 paragrafi 1 pika a), subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e informoi dhe e Urdhëroi që të ndërmarr masat përmirësuese lidhur me ankesën e datës 04.06.2014, po ashtu ka kërkuar që të përgjigjet ndaj kësaj ankese deri më datë 06.06.2014 në ora 09:00.

PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK në të cilën thekson se me të marrë urdhrin nga PZAP-i, ne kemi ndërmarr masat e nevojshme për heqjen e banerave të kandidatëve tanë nga vendet e cekura në urdhëresën e PZAP-it, duke e dëshmuar edhe me fotografi largimin e tyre nga vendi i ngjarjes dhe duke shpresuar që PZAP-i të merr për bazë këtë fakt dhe të marrë vendim meritore me të cilin LDK-ja nuk do të gjobitet.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesat gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 6.3 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka vendosur të bashkon ankesat e lartcekura dhe ti trajton si një ankesë për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe po ashtu për shkak të adresës së njëjtë të shkeljes së pretenduar, gjithashtu që të vendos për dy ankesat e lartcekura më një me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik LDK Xhavit Ukaj dhe Hatim Baxhaku janë të vendosura mbi rrugë publike, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, e cila dispozitë përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik LDK ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se banerat e kandidatëve për deputet kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik LDK, pas marrjes së kërkesës për përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar,

ka ndërmarr veprime të dukshme për evitimin e shkeljes duke i larguar menjëherë banerat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

Andaj PZAP-i, duke marrë parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik LDK është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterat e kandidatëve të saj janë të vendosura mbi rruge publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik LDK që ka ndërmarrë për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.156 /2014 më datën 06.06.2014.

**Kryesuesi i Panelit
Xhevdet Abazi**



PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*